

Работодавачот од ставот 1 на овој член на вработеното лице му исплатува најмалку минимална плата утврдена со закон за полно работно време.

Субвенцијата од ставот 1 на овој член се исплатува во период од 24 месеци врз основа на поднесено барање од работодавачот до Агенцијата, со обврска да го задржи на работа ова лице уште 24 месеци по завршувањето на периодот на субвенционирање.

Доколку работникот го откаже договорот за вработување, работодавачот на негово место може да вработи друг работник корисник на социјална парична помош.

Средствата за исплата на субвенцијата од ставот 1 на овој член се обезбедуваат од Буџетот на Министерството за труд и социјална политика, а ќе се исплаќаат преку Агенцијата.

Работодавачот кој неосновано ќе го откаже договорот за вработување од ставот 1 на овој член исплатата на средствата се прекинува, а работодавачот има обврска за враќање на средствата.

Ако работодавачот не ги исполни условите од ставовите 1 и 2 на овој член го губи правото на субвенција.

Поблиските услови и начинот на исплата на субвенцијата од ставот 1 на овој член ги пропишува министерот надлежен за работите од областа на трудот."

Член 5

Подзаконските акти согласно со овој закон ќе се донесат во рок од 60 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 6

Започнатите постапки за основање на агенции за посредување за вработување во земјата и во странство со наплата во министерството надлежно за работите од областа на трудот, ќе се завршат според законот кој важел во моментот на започнувањето на постапките.

Член 7

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PUNËSIM DHE SIGURIM NË RAST TË PAPUNËSISË

Neni 1

Në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003, 37/2004, 4/2005, 50/2006, 29/2007, 102/2008, 161/2008, 50/10, 88/10, 51/11, 11/12, 80/12 dhe 114/12), në nenin 27-a para paragrafit 1 shtohen dy paragrafë të rinj 1 dhe 2, si vijojnë:

"Procedura për themelimin e agjencisë për ndërmjetësim për punësim në vend dhe jashtë vendit me arkëtim, ngrihet me parashtrimin e kërkesës për lëshimin e licencës personit fizik.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për themelimin e agjencisë për ndërmjetësim në vend dhe jashtë vendit me arkëtim nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës."

Paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 bëhen paragrafë 3, 4, 5 dhe 6.

Neni 2

Në nenin 27-b paragrafët 5 dhe 6 shlyhen.

Neni 3

Në nenin 61-gj paragrafi 1 pas alineës 6 shtohet aline e re 7, si vijon:

"- refuzon punësim të subvencionuar;"

Neni 4

Pas nenit 98 shtohet nen i ri 98-a, si vijon:

"Neni 98-a

Punëdhënësi nga sektori privat, i cili do të punësojë person të papunësuar, shfrytëzues të ndihmës sociale në para, tek i cili nuk ka zvogëlim të numrit të të punësuarve me kohë të pacaktuar tre muaj para ditës së punësimit të të punësuarve të rinj, përveç se në raste të vdekjes ose pensionimit, do të marrë subvencionim për personin e punësuar në lartësi prej 80% nga lartësia e ndihmës sociale në para të paguar personit/amvisërisë për muajin paraprak, nga muaji në të cilin personi është punësuar.

Punëdhënësi nga paragrafi 1 i këtij neni, personit të punësuar i paguan së paku rrogë minimale të përcaktuar me ligj, për orar të plotë pune.

Subvencioni nga paragrafi 1 i këtij neni paguhet në periudhë prej 24 muajsh në bazë të kërkesës së parashtruar nga punëdhënësi në Agjenci, me obligim që ta mbajë në punë këtë person edhe 24 muaj pas mbarimit të periudhës së subvencionimit.

Nëse punëtori e prish marrëveshjen për punësim, punëdhënësi në vendin e tij mund të punësojë punëtor tjetër shfrytëzues të ndihmës sociale në para.

Mjetet për pagimin e subvencionit nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen nga Buxheti i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa do të paguhet përmes Agjencisë.

Punëdhënësi i cili në mënyrë të pabazuar do ta prishë marrëveshjen për punësim nga paragrafi 1 i këtij neni, pagesa e mjeteve ndërpritet, ndërsa punëdhënësi ka obligim për kthimin e mjeteve.

Nëse punëdhënësi nuk i plotëson kushtet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, e humb të drejtën e subvencionit.

Kushtet e përafërta dhe mënyrën e pagesës së subvencionit nga paragrafi 1 i këtij neni, i përcakton ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës."

Neni 5

Aktet nënligjore në pajtim me këtë ligj do të miratohen në afat prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Procedurat e filluara për themelimin e agjencive për ndërmjetësim për punësim në vend dhe jashtë vendit me arkëtim në ministrinë kompetente për çështje nga sfera e punës, do të përfundohen sipas ligjit në fuqi në momentin e fillimit të procedurave.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".